1509. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 5, dosje drejtimi për tregtinë nr. 8, 2 volume me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1973. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
1510. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 5, dosje drejtimi për ndërmarrjen-komunikacionit dhe komunale nr. 6, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1973. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
1511. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 5, dosje drejtimi për bujqësinë nr. 7, 2 volume me 22 (njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1973-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
1512. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 6, dosje për të dënuar në ngarkim të Q. M., nr. 5, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1980-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
1513. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 7, dosje agjenturore(kasapi) nr. 183, me 113 (njëqind e trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1987-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
1514. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 7, dosje formulare në ngarkim të B.K., nr. 734, me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
1515. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 7, dosje formulare në ngarkim të H.K., nr. 737, me 71 (shtatëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitin 1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
1516. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 7, dosje formulare në ngarkim të A.K., nr. 735, me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
1517. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 8, procesverbale asgjësimi, dorëzimi, listë veçimi pa numër, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1977-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
1518. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 8, procesverbale asgjësimi, dorëzimi, listë veçimi pa numër, me 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitin 1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
1519. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 8, procesverbale asgjësimi, dorëzimi, listë veçimi pa numër, me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
1520. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 8, procesverbale asgjësimi, dorëzimi, listë veçimi pa numër, me 45 (dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
1521. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 8, procesverbale asgjësimi, dorëzimi, listë veçimi pa nr., me 22 (njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
1522. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 8, procesverbale asgjësimi, dorëzimi, listë veçimi pa numër, me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
1523. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 8, procesverbale asgjësimi, dorëzimi, listë veçimi pa numër, me 89 (tetëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1988-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
1524. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 8, procesverbale asgjësimi, dorëzimi, listë veçimi pa numër, me 223 (dyqind e njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1989-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
1525. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 8, procesverbale asgjësimi, dorëzimi, listë veçimi pa numër, me 88 (tetëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1989-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
1526. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 9 dosje pa numër. Zarf me dokumente e fondit të veçantë për 6-mujorin e parë dhe të dytë të vitet.1981-1983. nr. 1-6 deri 7-14 me 4 (katër zarfe) fletë. Dosja daton në vitet 1981-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".
1527. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 1, dosari 9, Libri i llogarisë fondit të veçantë të vitin 1986 pa numër, me 2 (dy) fletë. Dosja daton në vitin 1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
1528. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 1, dosje e kontrollit operativ në ngarkim të M.Xh., nr. 489, me 1 volume, me 253(dyqind e pesëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1949-1988. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1529. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 1, dosje formuare në ngarkim Q. B., nr. 191, me 1 volume, me 144 (njëqind e dyzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1959-1990. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1530. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 2, dosje e kontrollit operativ në ngarkim të A.M., nr. 491, me 1 volume, me 191(njëqind e nëntëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1976-1989. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1531. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 2, dosje përpunimi në ngarkim të Xh.H., nr. 221, 221/1, me 2 volume, me 400 (katërqind) fletë. Dosja daton në vitet 1951-1989. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1532. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 3, dosje formulare në ngarkim të N.A., nr. 274, me 1 volume, me 57 (pesëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1977-1989 Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1533. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 3, dosje e kontrollit operativ në ngarkim të B.J., nr. 527, me 1 volume, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1977-1989 Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1534. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 3, dosje e kontrollit operativ në ngarkim të M.K., nr. 101, me 1 volume, me 120(njëqind e njëzet) fletë. Dosja daton në vitet 1955-1989. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1535. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 3, dosje e kontrollit operativ në ngarkim të S.H., nr. 368, me 1 volumn, me 206 (dyqind e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1956-1990. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1536. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 3, dosje formulare në ngarkim të Q. M., nr. 757, me 1 volumn, me 206 (dyqind e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1987-1988 Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1537. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 4, dosje drejtimi për ruajtjen e policisë nr. 11, me 2 volume, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1973-1989. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret".

1538. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autorit në fshatin Vlush nr. 118, me 2 volume, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1980-1991. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1539. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autori në Potom nr. 170, me 2 volume, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1985-1989. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1540. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autori për therje qengji në Potom nr. 205, me 2 volume, me 42 (dyzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1987-1990. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1541. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autori në Staraveçkë nr. 202, me 2 volume, me 100 (njëqind) fletë. Dosja daton në vitet 1987-1991. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1542. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autori për fletushka armiqësore nr. 115, me 1 volume, me 23 (njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1977-1989. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1543. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje kërkimi nr. 116, me 1 volumn, me 9 (nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1977-1985. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1544. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autori për shkrim anonim nr. 159, me 1 volumn, me 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitet 1983-1985. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1545. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi për djegie në Kakruk nr. 217, me 2 volume, me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1988-1989. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1546. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autori për prerje tubi nr. 218, me 1 volumn, me 10 (dhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1988. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1547. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autori për djegie nr. 221, me 2 volume, me 47 (dyzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1988-1990. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1548. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autori nr. 222, me 1 volumn, me 10 (dhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1549. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autori nr. 223, me 2 volume, me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1988-1989. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1550. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autori për djegie nr. 240, me 2 volume, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1551. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autori për djegie nr. 246, me 2 volume, me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1988-1989. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1552. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi autori për dëmtime nr. 195, me 2 volume, me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1990-1991. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1553. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi për dëmtime në Kakruk nr. 175, me 1 volumn, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1985-1988. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1554. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 5, dosje zbulimi për dëmtime nr. 174, me 2 volume, me 44 (dyzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1988-1989. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
1555. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 6, dosje personale dhe pune nr. 1328 "Injektori", në ngarkim të I.Z., me 2 volume, me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1978-1988. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1556. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 6, dosje personale dhe pune nr. 1222 "Lisi", në ngarkim të F.Sh., me 2 volume, me 43 (dyzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1976-1988. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1557. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 6, dosje personale dhe pune nr. 842 "Studenti" në ngarkim të T.Zh., me 2 volume, me 85 (tetëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1970-1988. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1558. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 6, dosje personale dhe pune nr. 683 "Bregu Stanit" në ngarkim të D.H., me 2 volume, me 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1955-1990. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1559. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 6, dosje personale dhe pune nr. 850 "Shqiponja" në ngarkim të F.K., me 2 volume, me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1970-1988. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1560. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 6, dosje personale dhe pune nr. 665 "Paqja" në ngarkim të S.D., me 2 volume, me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1964-1988. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1561. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 6, dosje personale dhe pune nr. 1896 "Rrebeshi" në ngarkim të Sh.M., me 2 volume, me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1987-1989. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1562. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 6, dosje personale dhe pune nr. 869 "Deti" në ngarkim të B.Q., me 2 volume, me 23 (njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1971-1980. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1563. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 6, dosje personale dhe pune nr. 862 "Gramozi" në ngarkim të N.Q., me 2 volume, me 91 (nëntëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1970-1988. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1564. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 6, dosje personale dhe pune nr. 1479 "Diamanti" në ngarkim të F.Q., me 2 volume, me 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1973-1988. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".
1565. Arkivi i Autoritetit, fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, arka 2, dosari 6, dosje personale dhe pune nr. 1355 "Poeti" në ngarkim të S.B., me 2 volume, me 70 (shtatëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1976-1988. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".

KRYETARI I KDZH
Dr. Gentiana Sula



KUJTESA DHE EDUKIMI QYTETAR

DREJTËSIA E TË MITURVE NË TË SHKUARËN, TAKIM ME AMBASADORIN E UNICEF

Tiranë, 10 janar 2025



Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, priti përfaqësuesin e UNICEF-it në Shqipëri, z. Murat Shahin, me të cilin zhvilloi një diskutim rreth çështjes komplekse të drejtësisë për të miturit gjatë regjimit komunist, njohjen, edukimin dhe parandalimin e përsëritjes.

Historia tragjike e Kampit të Tepelenës, një kamp përqendrimi ku vuajtën fëmijë nga familjet e kundërshtarëve politikë, është një nga dokumentimet më të fuqishme të AIDSSH-së. Fëmijët jetuan në kushte të rënda shëndetësore dhe sanitare, duke përjetuar kufizimin e lirisë, pa një proces të drejtë dhe mbeten ende të padëmshpërblyer.

Ambasadori Shahin shprehu interesin për bashkëpunim në: thellimin e praktikave të mbrojtjes së fëmijëve, duke adresuar çështje, si drejtësia për të miturit, diskriminimi ndaj fëmijëve të opozitës politike dhe pasojat e politikave pronataliste, ndër të tjera dhe edukimi i të rinjve mbi këta kapituj të errët të historisë shqiptare, duke theksuar rëndësinë e analizës historike për parandalimin e shkeljeve të të drejtave në të ardhmen, me qëllim konsolidimin e demokracisë dhe promovimin e paqes.

Në fund të takimit z. Murat Shahin tha se: “Të drejtat e fëmijëve janë themeli i një shoqërie demokratike. Nder të takojta zonjën Sula, një kampione për të drejtat e fëmijëve, ish-punonjëse e UNICEF-it që tani drejton AIDSSH-në. Ajo dokumenton praktikatat e rrënjësura të së kaluarës për të trajtuar çështje si drejtësia për të miturit dhe për të udhëhequr reformat e sotme.»

VIZITË DHE STUDIM NË AIDSSH

Tiranë, 13 janar 2025

Studentët e programit “Master Profesional Mësuesi në Histori” pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, zhvilluan një vizitë studimore në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH).



Gjatë kësaj vizite, ata patën mundësinë të konsultojnë dokumente arkivore me rëndësi historike dhe të zbatojnë njohuritë e tyre në kuadër të lëndës “Kërkimi në edukim”. Kërkesat studimore të paraqitura nga studentët shërbyen për realizimin e një detyre kursi, duke ndihmuar në zhvillimin e aftësive kërkimore dhe integrimin e tyre në procesin mësimor.

Kjo iniciativë përforcon bashkëpunimin ndërmjet institucioneve akademike dhe atyre arkivore, duke u dhënë mundësi studentëve të ndërtojnë një qasje të thelluar ndaj studimit të së kaluarës dhe përdorimit të burimeve arkivore në edukim.



KRYETARJA E AUTORITETIT TAKIM ME PRESIDENTIN BAJRAM BEGA

Tiranë, 14 janar 2025

Kryetarja e Autoritetit, Gentiana Sula dhe anëtarët e institucionit u pritën në një takim nga Presidenti i Republikës, Bajram Bega, një mbështetës i përhershëm i nismave për transparencën historike dhe drejtësinë sociale. Në këtë takim palët u ndalën në disa nga sfidat më të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria jonë si: verifikimi i kandidatëve në kuadrin e fushatës së ardhshme zgjedhore, për



të siguruar një proces të drejtë dhe të ndershëm; kërkimi dhe gjetja e të zhdukurve gjatë periudhës së komunizmit, si një akt human dhe historik; promovimi i ndërgjegjësimit mbi shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë diktaturës komuniste.

Gjatë diskutimit u theksua rëndësia e krijimit të një kulture të bazuar te pendesa e sinqertë dhe dhembshuria e vërtetë për ata që vuajtën pa faj. Një pendesë që nuk shoqërohet me veprime konkrete mbetet vetëm fjalë – angazhimi për t'i dhënë drejtësi viktimave dhe familjeve të tyre është prova më e mirë e sinqeritetit.

AIDSSH-ja beson se bashkëpunimi i ngushtë me Presidencën do të sjellë rezultate pozitive për të gjithë ata që kërkojnë të rikthejnë dinjitetin dhe të vërtetën e humbur të së kaluarës.

DISKUTIM ME FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE PËR PROJEKTET MBI EDUKIMIN PËR TË KALUARËN TOTALITARE

Tiranë, 15 janar 2025



Kryetarja e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) zhvilloi një takim me Prof. Dr. Arjana Muçen, përgjegjëse e Katedrës së Pedagogji-Psikologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, për të diskutuar mbi projektet që lidhen me edukimin mbi të kaluarën totalitare.

Gjatë takimit u vlerësua platforma edukative “Mësojmë nga e kaluara”, konceptuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit. Kjo nismë synon zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse nëpërmjet partneriteteve akademike dhe përfshirjes aktive të studentëve.

Platforma do të angazhojë posaçërisht studentët e mësuesisë dhe mësuesit e lëndëve të Historisë, Gjuhës, Letërsisë, Qytetarisë dhe Filozofisë, duke ofruar mundësi për të eksploruar tema të ndërlidhura me periudhën totalitare. Ndër veprimtaritë që do të zhvillohen përfshihen leksionet e hapura, klubet e librit, punimi me dëshmi gojore dhe profilizimi i individëve të prekur nga regjimi, përfshirë të dënuarit politikisht dhe të zhdukurit.

Gjithashtu, në takim u theksua rëndësia e qasjes gjinore dhe drejtësisë për të miturit në trajtimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe nevoja për të edukuar mbi traumat historike dhe pasojat e tyre.

Ky projekt, përmes bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe aktorëve akademikë, do të ndihmojë në formimin e një brezi të ri të mësuesve dhe studentëve të vetëdijshëm për historinë, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të ndërgjegjshme.

AIDSSH falënderon Prof. Dr. Arjana Muçen për bashkëbisedimin frytdhënës dhe mbështetjen në këtë nismë të rëndësishme.

DEKLARATË E KRYETARES SË AUTORITETIT

“Vila 31 të pasqyrojë edhe krimin, survejimin, kontrollin, përndjekjen dhe terrorin e ushtruar nga Sigurimi i Shtetit!”

Tiranë, 17 janar 2025



Sot, si Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, kam një propozim të hapur bashkëpunimi për shoqatën që administrojnë Vilën 31, tani e njohur si “Vila 31, Art Explora», banesë e pronarëve historike, të përndjekur, dhe më pas e Koçi Xoxes dhe Enver Hoxhës.

Koçi Xoxe dhe Enver Hoxha ishin dy nga figurat më të rëndësishme të regjimit komunist në Shqipëri, ku rolet e tyre në shtypjen dhe persekutimin e kundërshtarëve politikë janë të dokumentuara gjerësisht.

Koçi Xoxe, si Ministër i Brendshëm, drejtonte Sigurimin e Shtetit, një organ që u bë sinonim i represionit dhe terrorit gjatë viteve të para të komunizmit. Nën drejtimin e tij, Sigurimi i Shtetit zhvilloi fushatat e para të mëdha kundër “armiqve të klasës”, duke përdorur metoda të tilla si arrestime pa gjyq, tortura, dhe ekzekutime. Xoxe ishte i njohur për zbatimin me zell të politikave të Hoxhës, duke i dhënë një fytyrë të errët regjimit të ri në Shqipëri.

Enver Hoxha, nga ana tjetër, ishte udhëheqësi suprem i Shqipërisë komuniste dhe arkitekti kryesor i politikave që do të përcaktonin fatin e vendit për dekada. Ai personalisht nënshkruante platformat e punës dhe vendimet që çonin në shtypjen e opozitës, kolektivizimin e dhunshëm, dhe izolimin e Shqipërisë nga bota e jashtme. Dokumentet historike na tregojnë se ai shpesh nënshkruante me dorën e vet vendime që çonin në arrestime, dënime të rënda, torture dhe madje edhe ekzekutime, duke treguar përgjegjësinë e tij direkte për shumë nga krimet e regjimit komunist.

Unë besoj se këtu ka një mundësi të rëndësishme për të pasuruar përvojën e vizitorëve në këtë vend historik:

1. Duke organizuar një ekspozitë të përkohshme për të eksploruar jetën private të Enver Hoxhës dhe Koçi Xoxes në kontekstin e rolit të tyre drejtues e urdhërues në survejimin, kontrollin, përndjekjen dhe terrorin e ushtruar nga Sigurimi i Shtetit;
2. Duke mbajtur workshop-e dhe seminare mbi ndikimin e diktaturës në kulturën dhe artin shqiptar, duke theksuar propagandën dhe censurën;
3. Duke krijuar materiale informative për të dhënë një pasqyrë më të plotë të kohës së komunizmit në Shqipëri;
4. Duke shtuar ture të specializuara me histori dhe dëshmi nga dosjet e Sigurimit, për një edukim historik më të thelluar.

Gentiana Sula

DISKUTIM MBI MEMORIALIN “GURI I GJAKUT” NË SHKODËR

Shkodër, 31 janar 2025



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) vizitoi Shkodrën më, duke shënuar një hap të rëndësishëm në avancimin e projekteve përkujtimore.

Grupi i AIDSSH-së diskutoi dhe ndau mendime me përfaqësues të institucioneve lokale dhe organizatave shoqërore për avancimin e projekteve përkujtimore dhe dokumentimin e krimeve të regjimit ko-

munist. Gjatë takimeve u ndanë ide dhe propozime të rëndësishme për hulumtimet mbi të zhdukurit, mbështetje për memorialët dhe rehabilitimin e të përndjekurve.

Vizita nisi me një takim në Arqipeshkvinë e Shkodrës, ku grupi u prit nga Imzot Giovanni Peragine. Gjatë këtij takimi, Kryetarja Sula theksoi rëndësinë e hulumtimeve mbi të zhdukurit dhe viktimat e terrorit komunist, duke kërkuar mbështetje nga Arqipeshkvia për identifikimin dhe shenjëzimin e vendvarrimeve të klerikëve të pushkatuar. Përfaqësues të Arqipeshkvisë propozuan gjithashtu që një studiues të bashkëpunonte me Autoritetin për të thelluar kërkimet mbi këtë kategori viktimash.

Një tjetër pikë e rëndësishme e vizitës ishte takimi në Muzeun e Dëshmisë dhe Kujtesës, ku grupi u takua me anëtarë të Shoqatës Kombëtare të ish-të Përndjekurve Politikë. Gjatë diskutimeve, Kryetarja Sula prezantoi përpjekjet e Autoritetit për nisjen e hetimeve me metoda joinvazive për vendvarrimet e dyshuara, si dhe angazhimin institucional në zhvillimin e Simpoziumit “Kufijtë e Diktaturës,” i cili do të mbahet në Shkodër dhe Malësi të Madhe. Gjithashtu, u diskutua për projektin e memorialit “Muri i Gjakut”, një propozim i deputetes së Shkodrës, Greta Bardeli në Kuvendin e Shqipërisë, i cili synon nderimin e viktimave të regjimit komunist.



Për më tepër, Kryetaria Sula ofroi mbështetje për riorganizimin e Muzeut të Dëshmisë dhe Kujtesës, duke theksuar rëndësinë e aksesit të hapur në dokumentet që tani janë të aksesueshme për publikun. U diskutua gjithashtu për rehabilitimin e të përndjekurve dhe krijimin e memorialëve përkujtimore, duke kërkuar mbështetje për dokumentimin e personave të zhdukur dhe ndihmën e organizatave lokale për ndriçimin e këtyre ngjarjeve tragjike.

Takimi me Kryetarin e Bashkisë Shkodër, z. Benet Beci, ishte një tjetër moment kyç, ku u diskutuan projekte të përbashkëta, përfshirë restaurimin e Muzeut të Dëshmisë dhe Kujtesës dhe mbështetjen financiare për memorialin. Z. Beci shpreh gatishmërinë për të mbështetur iniciativat dhe projekte të tjera të rëndësishme përkujtimore, duke përfshirë organizimin e një simpoziumi të rëndësishëm për kufijtë e diktaturës në Shkodër, që do të mbahet më 30 Gusht, Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur.



Ky udhëtim i grupit të Autoritetit në Shkodër ishte një hap drejt dokumentimit dhe përkujtimit të viktimave të regjimit komunist, duke konfirmuar angazhimin e fortë të aktorëve lokalë dhe shoqërisë civile në ruajtjen e kujtesës historike dhe drejtësisë për ata që vuajtën padrejtësisht. Të gjithë pjesëmarrësit në këtë iniciativë kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të kontribuar në realizimin e memorialëve dhe projekteve për të ndihmuar në shërimin e plagëve të së kaluarës.

Vizita shënoi një hap të rëndësishëm në avancimin e projekteve përkujtimore të Autoritetit dhe konfirmoi gatishmërinë e aktorëve lokalë për të kontribuar në realizimin e memorialit dhe përpjekjet për identifikimin e vendvarrimeve të viktimave të regjimit komunist.

AIDSSH ZBARDH “FONDIN KOSOVA” ME 11 630 FASHIKUJ

Tiranë, 17 shkurt 2025

AIDSSH-ja ka vënë në dispozicion të studiuesve dhe kërkuesve shkencorë ‘Fondin Kosova’, një arkiv unik me 11 630 fashikuj, të ruajtur në 74 kasaforta, që mbartin dëshmi të rëndësishme mbi ngjarjet më të rëndësishme politike, sociale dhe kulturore të Kosovës nga viti 1944 deri në 1991, ku bien ne sy fashikuj mbi lëvizjet rinore kosovare dhe ato për mohimin e te drejtave të shqiptarëve të Kosovës, si dhe të tilla si dokumente dhe fakte mbi shpopullimin dhe largimin me dhunë nga territoret e tyre të shqiptarëve të Kosovës.



Fondi “Kosova” përbën një burim të çmuar për hulumtuesit, duke përfshirë dokumente mbi demonstratat e vitit 1981 dhe lëvizjet politike të viteve 1988-1989, por edhe mbi gjendjen e institucioneve arsimore-kulturore të asaj kohe, ndërkohë që shumë shqiptarë me origjinë nga Kosova, shtetas të ish-Jugosllavisë, mund të gjejnë dokumente rreth tyre, nëse janë ndjekur nga Ish -Sigurimi i Shtetit në fondet të tjera arkivore që nuk i përkasin këtij fondi.

Drejtori i Arkivit, Anton Dukagjini, shprehet se mes dokumenteve të shumta të ruajtura, veçohen disa dosje të rëndësishme, që hedhin dritë mbi ngjarjet më dramatike të historisë moderne të Kosovës, ndër të cilat, një dosje me tre vëllime dhe 687 faqe mbi demonstratat e Kosovës, 2 vëllime me 531 faqe, që dokumentojnë ndodhitë pas protestave, një dosje me 2 volume dhe 593 faqe, që analizon lëvizjet

e mëtejshme studentore, analiza dhe diskutime politike të ruajtura në 149 faqe nga Rezidenca e Beogradit (1972 -1981), fashikulli mbi ngjarjet e Kosovës (prill - maj 1981), seria e dosjeve të “goditjeve në Kosovë” (1975-1990) dhe informacione sekrete të KQ-së të PPSH-së mbi arrestimet, dhunën dhe torturat e përdorura nga organet jugosllave ndaj shqiptarëve; dosje mbi spastrimin etnik të shqiptarëve nga Kosova dhe ndikimin e tij në zvogëlimin e kombit shqiptar.

Fondi ruan gjithashtu dokumente të rëndësishme mbi personalitetet të njohura në lëvizjet e Kosovës për pavarësi, si Rexhep Qosja, Adem Demaçi, Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla, Ibrahim Rugova, e shumë të tjerë, duke ofruar një mundësi të rrallë për studiuesit që dëshirojnë të kuptojnë më thellë historinë dhe rezistencën e Kosovës.

Hapja e këtij fondi shënon një hap të rëndësishëm në zbardhjen e historisë së Kosovës dhe ruajtjen e kujtesës historike, duke u dhënë studiuesve mundësinë të hulumtojnë mbi një periudhë që ka lënë gjurmë të thella në fatet e kombit shqiptar.

MUZEALIZIMI I KUJTESËS RIKONFIRMOHET ANGAZHIMI I AIDSSH-SË PËR TRANSPARENÇË DHE DREJTËSI HISTORIKE

Tiranë 20 shkurt 2025



Të nderuar,

Mirë se ju gjej në këtë ngjarje të rëndësishme të Ditëve të Kujtesës! Ju falënderoj për zëmbësirë dhe përkushtim për mundësinë që na jepet ne, si Autoriteti i Dosjeve të Sigurimit, për të ndarë me ju një hap të rëndësishëm drejt transparencës, edukimit dhe drejtësisë historike.

Rëndësia e punës sonë qëndron në përkushtimin për të ndihmuar hulumtuesit, historianët dhe të gjithë qytetarët të përvetësojnë një mori dokumentesh që dikur ishin të mbyllura: nga arkivat sekrete të hapura rast pas rasti, deri te ato të deklasifikuara dhe të zbardhura me qasje të papenguar.

Këto dokumente, dikur të fshehura, sot ekzaminohen dhe ekspozohen për të ndriçuar të vërtetat historike dhe për të na mësuar nga e kaluara jonë.

Baza jonë ligjore buron nga ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, i cili na ngarkon me detyrën për të ruajtur, administruar dhe bërë të arritshme këto dokumente për publikun, duke promovuar një kulturë edukimi të bazuar në njohjen e historisë.

Po ashtu, ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” na detyron të trajtojmë me respekt dhe përgjegjësi një pjesë të dhimbshme të së kaluarës, përmes hulumtimit dhe dokumentimit të vendvarrimeve të dyshuara dhe atyre të ekzekutimit, për të sjellë drejtësi historike dhe për të edukuar brezat e ardhshëm.

Së bashku me iniciativa publike dhe private për muzealizim – si ato të Kampit të Tepelenës, Spaçit, “Murit të Gjakut” dhe “Shtegut të Lirisë” – ne luajmë një rol bashkërendues për të sfiduar stereotipat e vjetër të narrativave të ngurta. Pa qasje në arkiva, këto narrativa kishin humbur besueshmërinë dhe nuk i shërbenin shoqërisë për reflektim.

Sot, Autoriteti ynë ka kaluar nga një qasje e “open access” në një infrastrukturë të “quick access”, duke lehtësuar jo vetëm qasjen fizike, por edhe atë digjitale ndaj këtyre arkivave. Ky proces hap rrugën për një diskutim të shpejtë, të hapur dhe të plotë, ku çdo qytetar mund të kontribuojë në ndriçimin e historisë sonë.

Edukimi mbetet përparësia jonë kryesore – si për të rriturit, veçanërisht mësuesit, ashtu edhe për të rinjtë. Duke integruar këto dokumente në kurrikulat shkollore, programe edukative për të rriturit, ture të specializuara dhe muzetë, ne po ndërtojmë një shoqëri të vetëdijshme për të kaluarën e saj. Një e kaluar e kuptuar mirë është çelësi për një të ardhme më të drejtë dhe demokratike.

Nuk mund të lë pa përmendur edhe bashkëpunimet tona ndërkombëtare. Përmes rrjeteve si ENRS, Rrjetit Evropian të Arkivave Sekrete dhe partnerëve të tjerë seriozë jashtë vendit, me të cilët, prej 2017, shkëmbejmë përvoja, ide dhe programe. Në kuadër të Ditëve të Kujtesës, nesër organizojmë një aktivitet ku do të prezantojmë modalitetet e bashkëpunimit me AIDSSH dhe pushtetit vendor, një hap tjetër drejt forcimit të këtyre përpjekjeve.

Në fund, dëshiroj të uroj nga zemra IDMC-në, e cila sot feston 10-vjetorin e platformës së kujtesës. Puna juaj ka qenë një frymëzim për ne të gjithë. Përkushtimi juaj ndaj ruajtjes dhe promovimit të kujtesës historike, në harmoni me standardet e transparencës të Bashkimit Evropian, të drejtave të njeriut dhe ligjit humanitar ndërkombëtar, na ka nxitur të përmirësohemi çdo ditë. Ju falënderojmë për kontributin tuaj të çmuar në edukimin dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë sonë.

Le të vazhdojmë së bashku në këtë rrugë drejt një transparence më të madhe, duke e kthyer historinë tonë në një mësim të përjetshëm.

Ju faleminderit!

*Fjala e plotë e Dr. Gentiana Sula Konferencën Ndërkombëtare mbi Muzealizimin e Kujtesës.

DIALOGU ME VENDIMARRJEN LOKALE: “JO MË TITUJ NDERI PËR FIGURAT E DIKTATURËS!”

Tiranë 21 shkurt 2025

Ankesa e një grupi qytetarësh, drejtuar bashkisë X, në lidhje me një shtetas me të kaluar të dyshimtë, nderuar nga Këshilli Bashkiak në emërtimin e një rruge vuri në lëvizje Autoritetin e Dosjeve për të verifikuar faktet e dyshuara.

“I nderuari” ishte një gjyqtar që kishte firmosur dënimin me vdekje të 27 qytetarëve. Verifikimet bazuar në ligjin nr. 45/2015, treguan se “X” kish shërbyer si ndihmësgjyqtar, gjyqtar dhe hetues në Gjykatën Ushtarake gjatë viteve 1945-1953. Ai ishte i përfshirë në 238 dosje me 395 të akuzuar politikisht. Trupa gjykuese ku ai bënte pjesë dha 27 dënime me vdekje (nga këto 16 të ekzekutuara pas rekur-sit), burgime të përjetshme, dënime me 20 apo 10 vjet, heqje të të drejtave civile dhe konfiskime pasurie. Kështu, emërtimi i rrugës me emrin e tij është vënë në pikëpyetje për shkak të historikut të tij të lidhur me represionin e diktaturës.



Në kuadër të Ditëve të Kujtesës, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) zhvilloi dialogun me përfaqësues të pushtetit vendor në tre drejtime: ndërgjegjësimin e bashkive në zbatim të ligjit për verifikimin e figurës së kandidatëve për dekorata, tituj nderi, emërtimin e rrugëve dhe hapësirave publike; ndërtimin e mekanizmeve në trajtimin e vendvendimeve të dyshuara të ekzekutiveve, varreve të pushësuar dhe vendeve të kujtesës; si dhe bashkëpunimin me institucionet arsimore, bibliotekat dhe muzetë lokalë, për të nxitur edukimin dhe ndërgjegjësimin mbi të kaluarën.

“Debati mbi modelet fisnike të shoqërisë bëhet përherë edhe më aktual. Ne mendojmë se modeli fisnik i qytetarit është ai që i shërben komunitetit në plotësimin e nevojave, përmes sakrificës dhe përkushtimit,”- u shpreh Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula.



A mund të jetë model fisnik i shoqërisë kush dëmton të tjerët, në emër të pushtetit dhe privilegjeve të veta? Ne shpresojmë që në kërkim të modeleve të shoqërisë, çdo entitet që lëshon medalje, nderime, emra rrugësh dhe shkollash, të jetë i informuar në vendimet për këto nderime, sepse kjo do të ndikojë në modelet frymëzuese që zgjedh shoqëria jonë sot e në vijim. Në aspektin njerëzor, këto nderime nuk duhet të rizgjojnë dhembjet apo dasitë e vjetra. Njohja e autoriteteve lokale me instrumente ligjore që tashmë BE dhe shteti shqiptar ka adoptuar, si dhe krijimin e një mekanizmi të përbashkët për të identifikuar dhe korrigjuar emërtimet problematike mbetet synimi i këtij dialogu. Është detyrë e vendimmarrjes lokale të jetë më transparente dhe në përputhje me drejtësinë historike, duke shmangur rastet flagrante si nderimi i një gjyqtari që ka dënuar me vdekje 27 të pafajshëm. I takon pushtetit vendor të largohet nga modeli i thashethemeve apo anashkalimit të fakteve, që të njihet e të hulumtoje me kujdes rolin e secilit, tashmë të informuar dhe të krijojë kushte që këshillat bashkiake të marrin vendime sa me të vlefshme për komunitetin e tyre.



Sot ka një numër në rritje të bashkive (19) që bashkëpunojnë me AIDSSH për të verifikuar kandidatët për nderime e medalje. Po përsëri ky numër nuk është i plotë. Ndaj ky dialog i hap rrugë forcimit të rolit të pushtetit vendor në proceset e transparencës dhe kujtesës historike, duke kontribuar në ndriçimin e së kaluarës dhe respektimin e dinjitetit të viktimave të regjimit të shkuar.”

Ermal Elezi, Drejtor i Agjencisë së Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, përshëndeti iniciativën dhe tha se: “Bashkitë kanë nevojë për mbështetje për të vepruar me transparencë në drejtim të verifikimit të figurave që nderojnë qytetin dhe komunitetin.”



Në fjalën e saj, Liliana Çoçoli, Drejtore e Drejtorisë së Verifikimit të Figurave, tha se: “Rastet e hasura gjatë punës sonë tregojnë se verifikimi është çelësi për të shmangur gabimet. Gjatë 2022-2024, AIDSSH ka bashkëpunuar me 61 bashki, ku 26% e tyre (16 bashki në 2024) kanë kërkuar verifikime. Nga 157 kandidatë të kontrolluar, 24 rezultuan të implikuar me ish-Sigurimin e Shtetit, duke nxjerrë në pah mangësi në proceset aktuale. Dialogu i sotëm hedh bazat për një proces më të rregullt dhe të drejtë, në zbatim të ligjit për procedura më të qarta dhe efektive në verifikimin e figurave të propozuara për nderime publike.”



“Bashkëpunimi me AIDSSH-në na ndihmon të respektojmë viktimat dhe mbështesim fort Autoritetin në nismën për rikuperimin e të zhdukurve në komunizëm. Ikën 34 vjet pa gjetur të zhdukurit tanë. Mbështes Autoritetin dhe në shenjë detyrimi ligjor, por edhe borxhi shpirtëror e moral, do bëjmë të pamundurën t'i rikthejmë dinjitetin familjeve që ende nuk kanë një varr për të afërmit e tyre,” - tha Kryetar i Bashkisë Mirditë, Albert Mëlyshi.

Brunilda Çërraga, Drejtuese e Programit të Edukimit Qytetar, u shpreh se: “Bashkëpunimi me pushtetin lokal në drejtim të zhvillimit edukimit qytetar mbi të kaluarën është i domosdoshëm, lidhja me komunitetin dhe shkollën, si dhe transmetimi i historive që shënuan viktimat gjatë komunizmit janë e vetmja mundësi për të mos harruar dhe dialoguar me të shkuarën. Në partneritet me pushtetin vendor po vijojmë realizimin e klubeve të librit, aktiviteteve përkujtimore dhe kthimit të vendeve historike në pika kujtese.”



Nertila Seitaj, Drejtore e Drejtorisë së Procesit të Rikuperimit të Trupave të Zhdukurve në diktaturë, çmoi nevojën e bashkëpunimit me pushtetin lokal: “Vendvarrimet e dyshuara janë dëmtuar ose mbuluar nga ndërtimet, bujqësia dhe projektet infrastrukturore për shkak të mungesës së masave mbrojtëse nga institucionet. Ndërhijet e paligjshme dhe neglizhenca rrezikojnë humbjen e pakthyeshme të këtyre gjurmëve historike. Identifikimi dhe shënimi i këtyre vendeve me tabela është urgjent për të parandaluar zhdukjen e tyre. Çdo varr ende i dyshuar meriton një emër dhe mbështetja e pushtetit lokal në drejtim të trajtimit të vendvarrimeve të dyshuara, varreve të pashënuara dhe vendeve të kujtesës është thelbësor.”

Nën moderimin e Sekretares së Përgjithshme të Autoritetit, Sofi Noti, sesioni i diskutimeve solli propozime praktike, si dhe përforcoi detyrimet e bashkëpunimit dypalësh me një rëndësi të madhe për shoqërinë shqiptare. Të pranishmit u njohën edhe me arkivin dhe ekspozitat informuese dhe edukuese.

Shkeljet e të drejtave të njeriut që janë kryer gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri kanë lënë plagë të thella në shoqërinë tonë që ndihen edhe sot. Viktimat dhe familjet e tyre bashkëjetojnë me autorët e këtyre plagëve dhe janë ende në kërkim të drejtësisë dhe të vërtetës. Nga ana tjetër, individë pjesëtarë të aparatit shtypës apo ata që nuk ndërhyjnë për t’i ndihmuar viktimat, sot nderohen me tituj nderi ose emri dhe kontributi i tyre vlerësohet me emërtime rrugësh.

Shumë ish - të përndjekur politikë, si persona të prekur drejtpërdrejt nga regjimi komunist apo edhe familjarë të tyre, kanë shprehur shqetësimin pranë institucioneve që mbrojnë të drejtat e njeriut, lidhur me përdorimin dhe emërtimin e rrugëve shesheve dhe hapësirave publike me data dhe simbole që lidhen me personazhe që i përkasin të kaluarës shtypëse të regjimit komunist.

AIDSSH DISKUTIM PËR “SHTEGU I LIRISË” DHE MANUALIN PËR PUSHTETIN VENDOR NË KOLONJË

Kolonjë, 25 shkurt 2025



Historia nuk mund të mbetet e fshehur. As ata që e shkruan me dhimbje dhe gjak, as ata që tentuan ta zhbëjnë.

Në një takim me kryetarin e Bashkisë së Kolonjës, Erion Isai, dhe ekipin e tij drejtues, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) solli në vëmendje një sërë iniciativash që synojnë të zbardhin të shkuarën dhe të nxisin reflektimin e shoqërisë mbi të.

Në qendër të diskutimeve ishte memoriali “Shtegu i Lirisë”, një projekt për të përkujtuar shqiptarët që ranë në përpjekje për t’u larguar nga regjimi totalitar, duke kaluar kufirin mes rrezikut dhe shpresës. Artistja e njohur e artit vizual, Anila Zajmi, prezantoi konceptin artistik të këtij memoriali që do të shndërrohet në një pikë referimi për brezat e ardhshëm.



Një tjetër iniciativë madhore e këtij bashkëpunimi është shënimi dhe mbrojtja e vendvarrimeve të dyshuara të të pagjeturve, një angazhim për të mos lejuar që të zhdukurit të mbeten thjesht një numër në dosje. Me ndihmën e Bashkisë së Kolonjës ky proces do të sigurojë dokumentimin dhe mbrojtjen e vendeve ku prehen ata që historia i la në harresë.

Në respekt të ligjit dhe të drejtësisë historike, u trajtua edhe aplikimi i manualit për verifikimin e figurave që propozohen për tituj nderi. Kjo është një sfidë thelbësore për të garantuar që personalitetet e vlerësuar nga bashkitë të kenë një të shkuar të pastër, duke mos qenë të lidhur me mekanizmat shtypës të regjimit komunist.

Ky takim konfirmoi se hapja e dosjeve dhe zbardhja e së shkuarës nuk janë vetëm një detyrë ligjore, por një domosdoshmëri për një shoqëri që dëshiron të ndërtojë të ardhmen mbi themele të së vërtetës. “Dosja e Hapur” do të vijojë të mbështesë këtë proces, duke ofruar mundësi për studiuesit dhe individët të njohin historinë dhe të kërkojnë të vërtetën e tyre. Kolonja bëhet kështu një shembull se si kujtesa historike nuk duhet të mbetet në arkiva, por të bëhet pjesë e ndërgjegjes kolektive.



AUTORITETI PER INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TE SHTETIT

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga e Dibrës, garnizoni "Skënderbej", Tiranë